



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:225602

Datë: 24.01.2024

Numri i dokumentit: 05236292

**Në ankesën e**

**AC-I-23-0058**

**Paditësi**

**A J**, Prishtinë, të cilin e përfaqëson S J, avokate,

**kundër**

**E paditura/Ankuesja**

**NSH, "Energomontimi"(në likuidim)**, të cilën e përfaqëson, Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rr. "Dritan Hoxha", nr.55, Lakrishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Ilmi Bajrami dhe Agron Hoxhaj gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditurës të paraqitur kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-14-2874 të datës 17 janar 2023, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 24 janar 2024, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**

- 1. Ankesa e të paditurës refuzohet si e pa bazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktgjykimi i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-14-2874, i datës 17 janar 2023.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

## **Rrethanat procedurale dhe faktike**

Me datë 17 prill 2014, përmes postës paditësi e dërgoi në DHPGJS-ë një ankesë kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit PRN073-0069, të datës 12 mars 2014, me të cilën kërkesa e paditësit e datës 08 janar 2014 për kompensimin të 3 pagave të pa paguara në periudhën e pa specifikuar në shumë prej 863.94 euro, refuzohet si e pa vlefshme me arsyetimin se kërkesa është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. Në ankesë paditësi ka pohuar se me datë 28 prill 2006, e ka pranuar njoftimin nga AKM-ja për ndërprerjen e marrëdhënies së punës si rezultat i privatizimit të NSH "Energomontimi" dhe në këtë njoftim ai ka pohuar se është theksuar se punëtorët do të njoftohen lidhur me kërkesat për pagat e pa paguara pas fillimit të procedurës së likuidimit të NSH-së. Tutje ai pohon se ka bërë kërkesë tek Autoriteti i Likuidimit me datë 08 janar 2014, e cila pa ndonjë bazë është refuzuar kinse është parashkruar kërkesa. Bashkë me ankesë paditësi ka dorëzuar autorizimin e avokatit, vendimin e Autoritetit të Likuidimit.

Me datë 24 qershor 2021, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS-ë mbrojtjen në ankesë në të cilën AKP-ja pohon se e mbështet qëndrimin e Autoritetit të Likuidimit, i cili ka bërë vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht. AKP-ja pohon se vendimi i ankimuar nuk bie ndesh me asnjë dispozitë ligjore të Ligjit të AKP-së, prandaj nuk ka bazë ligjore të shfuqizohet vendimi i ankimuar. Tutje AKP-ja pohon se NSH "Energomontimi" është privatizuar me datë 27 prill 2006, dhe të gjithë punëtorëve me këtë datë u është ndërprerë marrëdhënia e punës, prandaj punëtorët kërkesat për paga është dashur ti kërkojnë më së voni 3 vite nga data e ndërprerjes së marrëdhënies së punës. AKP-ja pohon se ajo nuk ka asnjë dëshmi se paditësi i ka kërkuar këto paga para ndonjë gjykate apo organi tjetër kompetent në afat prej 3 vitesh, andaj kërkesa është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Me datë 09 nëntor 2022, shkalla e I-rë e DHPGJS-së e lëshon një Urdhër për paditësin, me të cilën ka kërkuar nga paditësi të dorëzoi dëshmi shtesë në mbështetje të ankesës.

Me datë 25 nëntor 2022, paditësi e dorëzoi në DHPGJS një parashtresë si përgjigje ndaj Urdhrit. Me këtë parashtresë paditësi ka dorëzuar njoftimin e AKM-së për

ndërprerje të marrëdhënies së punës, dhe kopjen e listave të pagave nga muaji tetor 2005 e deri në mars 2006.

Me datë 17 janar 2023, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së, me Aktgjykimin C-IV-14-2874, ankesën e paditësit e aprovoj pjesërisht si të bazuar, e ndryshon vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit, dhe e obligon AKP-në që paditësit në emër të kompensimit për 3 paga të pa paguara, ti paguaj shumën prej 813.86 euro, e cila do të paguhet sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit. Shkalla e I-rë e DHPGJS-së ka arsyetuar se mes palëve nuk është kontestues fakti se paditësi ishte një punëtor i NSH "Energomontimi" mirëpo kontestues paraqitet qështja e parashkrimit të kërkesës. E paditura pretendon se kërkesa për këto paga është e parashkruar ndërsa paditësi e konteston këtë qëndrim të AKP-së, ndërsa bazën e kërkesës e mbështet në listat e pagave të pa paguara për muajt janar, shkurt dhe mars 2006, dhe njoftimin e AKM-së për ndërprerje të marrëdhënie të punës. Tutje Shkalla e I-rë konstaton se në bazë të listave të pagave të paraqitura në Gjykatë nga paditësi shihet se për muajin janar, shkurt dhe mars 2006, i është njohur shuma totale prej 813.86 euro. Tutje Shkalla e I-rë konstaton se Gjykata u ka besuar këtyre provave andaj në bazë të tyre është aprovuar kërkesa për tri paga të pa paguara para privatizimit të NSH-së.

Me datë 01 shkurt 2023, AKP-ja përmes postës e dërgon një ankesë të afatshme kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së C-IV-14-2874 të datës 17 janar 2023, për të gjitha bazat ankimore dhe kërkon nga Kolegji i Apelit të aprovohet ankesa si e bazuar, të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar, të refuzohet ankesa e paditësit si dhe të vërtetohet vendimi i Autoritetit të Likuidimit. Për më tepër në ankesë AKP-ja ka pohuar se Gjykata e Shkallës së I-rë është tërësisht jashtë kontestit faktik të çështjes. Tutje AKP-ja pohon se Gjykata gjatë shqyrtimit të çështjes i ka ngatërruar dy çështje krejtësisht të ndryshme, njëra që ndërlidhet me afatin për parashtrimin e kërkesave i cili afat i përket procedurës së dorëzimit të dëshmisë së kërkesës dhe afati i dytë ka të bëjë me natyrën ( meritat e të drejtës e që ka të bëjë me afatin e parashkrimit të kërkesës e që në këtë rast është 3 vite në bazë të nenit 608 të Ligjit të punës së Bashkuar. Tutje AKP-ja pohon se njoftimi për ndërprerje të marrëdhënies së punës i dërguar tek paditësi ka pas për qëllim të informon atë se ai ka të drejtë të parashtrij kërkesë pranë AKP-së dhe se ky njoftim nuk i mbron të drejtat e tij dhe nuk siguron mjete ligjore që ai ka në dispozicion.

Tutje AKP-ja pohon se kërkesa e paditësit për 3 paga është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar pasi që ai nuk ka dorëzuar dëshmi ti ketë kërkuar këto paga brenda 3 viteve pas datës së privatizimit të NSH-së që ka ndodhë me datë 27 prill 2006.

Me datë 06 prill 2023, paditësi e dorëzoi një parashtrësë në DHPGJS dhe përgjigjet në ankesën e AKP-së. Në këtë parashtrësë paditësi i kundërshton pretendimet ankimore të AKP-së duke i konsideruar si të pa bazuara në ligj dhe e mbështet në tërësi Aktgjykimin e ankimuar të cilin e konsideron si të drejtë dhe të bazuar në ligj. Paditësi pretendon se në mënyrë të plotë dhe të drejtë është vërtetuar gjendja faktike me provat e administruara nga Shkalla e I-rë dhe gjithashtu në mënyrë të drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale. Paditësi ka kërkuar që të refuzohet ankesa e AKP-së si e pa bazuar.

### **Arsyetimi ligjor:**

Ankesa e të paditurës refuzohet si e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

### **Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit**

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj ai duhet të vërtetohet .

Kolegji i Apelit vëren se kërkesa e paditësit e datës 08 janar 2014, e dorëzuar tek Autoriteti i Likuidimit për pagesën e 3 pagave të pa paguara në shumë prej 863.94 euro nga NSH "Energomontimi" (në likuidim) është refuzuar si e pa vlefshme me arsyetimin se kërkesa është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Kolegji i Apelit vëren se ankesa e paditësit e datës 17 prill 2014, i referohet kërkesës për 3 paga të papaguara në emër të kompensimit për shkak të ndërprerjes së

parakohshme së kontratës së punës, të cilat paditësi pretendon se NSH-ja“ Energomontimi” (në likuidim) i ka mbetur borxh.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me parashtresën e tij të dorëzuar në Shkallën e I-rë me datë 25 nëntor 2022 e ka mbështetur me prova të mjaftueshme, duke dorëzuar përveç vendimit të Autoritetit të Likuidimit, kopjen e Njoftimit të AKM-së për ndërprerje të marrëdhënies së punës me datë 28 prill 2006, dhe listat e pagave për muajin janar 2006, shkurt 2006, mars 2006 të nënshkruara nga ana e arkëtarit, udhëheqësit financiar dhe drejtorit të NSH-së. Me këto dëshmi paditësi padyshim ka vërtetuar se ai kishte të drejtë të i njihet e drejta e kompensimit për 3 paga të papaguara, por që kjo e drejtë duhet të njihet në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës.

Prandaj nga këto arsye, e duke u bazuar në provat e bashkangjitura, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me të drejtë e kishte aprovuar ankesën e paditësit si të bazuar dhe e kishte ndryshuar vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit pasi që nuk mbështetej në dispozita ligjore. Shkalla e I-rë e DHPGJS-së duke u bazuar në listat e pagave për tre muajt e fundit para privatizimit të NSH-së, përkatësisht për muajin janar, shkurt dhe mars 2006, ia ka njohur të drejtën e kompensimit të tri pagave të pa paguara në shumë prej 813.86 euro, e cila duhet të paguhet nga ana e AKP-së, sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit.

Kolegji i Apelit në rastet e mbyllura në jurisprudencën e tij, shumë herë ka konstatuar se Njoftimi për ndërprerje të marrëdhënies së punës e ndërprejnë afatin e parashkrimit. Prandaj nuk mund të mbështetet konstatimi i gabuar i Autoritetit të Likuidimit se kërkesa për 3 paga të papaguara të kërkuara nga paditësi në periudhën e cekur, është parashkruar.

Nga këto arsye, ankesa e AKP-së është refuzuar si e pa bazuar, dhe është vërtetuar Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Prandaj nga këto arsye, e në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

## **Taksat gjyqësore**

Ankuesja tashmë e ka paguar taksën gjyqësore me datë 21 shkurt 2023, për procedurën ankimore në shumë prej 100 euro, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 24 janar 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar kryesues

\_\_\_\_\_